



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada – Government  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	KOMUNA • OPSTINA • MUNICIPALITY	HANI I ELEZIT
Nr.i Prot. 02	10191	
Nr.i Faq. 5		Data. 07.12.2023

FALSE - IZLAZNA - OUTGOING	
MINISTRIA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA	
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration	
Komuna e Hani i Elezit Opština Elez Han Municipality of Hani i Elezit	
Nr. Br. No.	454-963
Data Datum Date	08.12.2023

### MARRËVESHJE TREPALËSHE E NËNGRANTIT 04/HE/2023

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Rr. Luan Haradinaj, ndërtesa e re e Qeverisë (ish ndërtesa e "Rilindjes"),

Katet: 11, 12 dhe 13, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

(Agjencia zbatuese e projektit M4Y, në tekstin e mëtejmë "MAPL")

#### Komuna e Hani i Elezit

Rr. "Nuri Bushi" Nr. 2, 71510 Hani i Elezit

(përfituesi i projektit M4Y dhe bashkë financuesi i nëngranteve, në tekstin e mëtejmë "Komuna")

dhe

#### Klubi i mundjes "Sharri"

(Lider i grupit: Sumea Asallari )

Numri zyrtar i regjistrimit të organizatës: 5110937-6

Llogaria bankare: 1704200004000916

Adresa: Rr. Xhemsedin Suma

(në tekstin e mëtejmë "Përfituesi i nëngrantit")

janë pajtuar si në vijim:

## Neni 1 - Qëllimi

- 1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshje është dhënia e nëngrantit të siguruar nga Qeveria e Japonisë përmes Fondit Japonez për Zhvillim Social (JSDF) i cili administrohet nga Banka Botërore dhe zbatohet nga MAPL për financimin e zbatimit të nënprojektit me titull: “**Digjitalizimi i organizimit të garave**” (në tekstin e mëtejmë ‘Nënprojekti’).
- 1.2 Përfituesit të nëngrantit do t'i jepet granti sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, Doracakun e Operacionit të Projektit (DOP) dhe Doracakun e Nëngrantit (DNG), të cilin Përfituesi i nëngrantacionit deklaron se i ka vënë në dukje dhe pranuar.
- 1.3 Përfituesi i nëngrantit pranon grantin dhe merr përsipër të jetë përgjegjës për realizimin e Nënprojektit.

## Neni 2 — Periudha e zbatimit të Nënprojektit

- 2.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të gjitha palët në marrëveshje.
- 2.2 Zbatimi i Nënprojektit fillon me datën e nënshkrimit të marrëveshjes.
- 2.3 Projekti duhet të përfundoj implementimin deri me datën **15.06.2024**

## Neni 3 — Financimi i Nënprojektit

- 3.1 Shpenzimet e përgjithshme të pranueshme përllogariten në Euro **1,000.00€**, për Nënprojektin.
- 3.2 MAPL merr përsipër t'i ndajë 85 % të vlerës së përgjithshme të Nënprojektit nga fondi i donatorëve: **850.00€**
- 3.3 Komuna merr përsipër të financoj 15% nga buxheti i saj (15% e vlerës së përgjithshme të Nënprojektit): **150.00€**

## Neni 4 — Rregullimet e pagesës

- 4.1 Për nëngrantet ku shuma e përgjithshme (kur mblidhen shuma e MAPL-së dhe komunës) ndryshon nga 1,000 deri 14,500 Euro, shuma e përgjithshme e dhënë do të paguhet si parafinancim, pas nënshkrimit të marrëveshjes së Nëngrantit.

- 4.2 Pagesat e Nëngrantit do të realizohen në dy këste:

- 4.2.1 Kësti i parë (në shumën 15% të kontributit në nëngrant) do të paguhet nga Komuna për pjesën e saj të kontributit.
    - 4.2.2 Kësti i dytë (në shumën 85% të kontributit në grantit) do të paguhet nga MAPL pas konfirmimit nga komunat pjesëmarrëse që vërteton se 15% e shumës së projektit u është shpërndarë përfituesve. Përfituesi dorëzon Kërkesën për Pagesë (Shtojca 5.1).

4.3 Për të marrë këstин, përfituesi i Nëngrantit duhet t'i siguroj MAPL-së dokumentet mbështetëse të cekura në DNG si dhe çfarëdo dokumenti tjetër shtesë që konsiderohet i nevojshëm për t'i mundësuar MAPL-së transferimin e mjeteve.

4.4 Përjashtimi nga TVSH-ja, shpenzimet e kryera sipas kontratave të granteve të dhëna për operacionet e përgjedhura do të përjashtohen nga të gjitha tatimet, detyrimet doganore dhe tarifat e tjera fiskale në përputhje me legjislacionin kombëtar.

#### **Neni 5 – Detyrimet e MAPL-së**

5.1 MAPL-ja është përgjegjëse për menaxhimin e përgjithshëm financiar të projektit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). MAPL-ja do të ndajë 85% të vlerës së përgjithshme të projektit pas marrjes së konfirmimit nga komuna pjesëmarrëse që vërteton se 15% e shumës së projektit është shpërndarë për përfituesit e Nëngrantit. MAPL-ja do t'i ndajë mjetet brenda 1 muaji pas marrjes së konfirmimit nga komuna se mjetet i janë shpërndarë përfituesit të Nëngrantit.

5.1.1 MAPL-ja rezervon të drejtën për monitorimin dhe vlerësimin e realizimit të projektit, duke përfshirë financat dhe rishikimin e shpenzimeve në vazhdimësi në çdo kohë gjatë projektit përmes njoftimit paraprak prej shtatë ditësh. MAPL-ja do të pranojë vetëm pagesa të cilat janë në përputhje me shumën e dhënë të Nëngrantit siç parashihet në aplikacionin për Nëngrant.

5.1.2 MAPL është e obliguar që të bëj aprovin e planit të prokurimit të përfituesve. Pa e bërë aprovin e planit të prokurimit përfituesit, përfituesit nuk mund të zhvillojnë procedura për aktivitetet e prokurimit.

#### **Neni 6 – Detyrimet e komunës**

6.1 Komuna është përgjegjëse për menaxhimin e fondevë (15% të vlerës së përgjithshme të nënprojektit) të ndara për përfituesit e nëngrantit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Komuna do t'i ndajë 15% të vlerës së përgjithshme të nënprojektit përfituesit e nëngrantit brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshje dhe dorëzojnë konfirmimin në MAPL si dëshmi se pagesa është kryer.

6.2 Komuna do të pranoj vetëm pagesa të cilat janë në përputhje me shumën e dhënë të nëngrantit siç parashikohet në aplikacionin për nëngrant.

6.3 Komuna do ta siguroj hapësirën dhe pajisjet e nevojshme për takime për ekipet e nënprojektit.

#### **Neni 7 – Detyrimet e përfituesit të nëngrantit**

**7.1 Përfituesi i nëngrantit përdor fondet nga neni 3 i kësaj marrëveshje vetëm për zbatimin e nënprojektit dhe siç përcaktohet në buxhetin e nënprojektit.**

**7.2 Përfituesi i nëngrantit është i obliguar të siguroj çdo dokument ose informatë që kërkohet nga tërë aktorët e përfshirë në zbatimin e nënprojektit siç ceket në DOP dhe DNG.**

**7.2.1 Përfituesi i nëngrantit është i obliguar të mbaj shënime për transaksionet financiare të nënprojektit dhe aktivitetet e prokurimit të përcaktuara në DNG dhe ta dorëzoi raportin finansiar në MAPL me dokumentacionin e të gjitha shpenzimeve dhe shtojcat.**

**7.2.2 Përfituesi i nëngrantit është i obliguar që të përpiloj planin e prokurimit për aktivitetet që duhet të procesohen permes procedurave të prokurimit sipas doracakut të granteve. Përfituesi duhet të merr aprovim nga MAPL lidhur me planin e prokurimit, përpala se të filloj zhvillimin e ndonjë procedure për aktivitetet e prokurimit.**

**7.3 Përfituesi i nëngrantit është i obliguar të raportoj për progresin e nënprojektit dhe ta dorëzoi raportin përfundimtar narrativ në MAPL.**

**7.4 Përfituesi i nëngrantit duhet ta siguroj dukshmërinë e donatorëve gjatë zbatimit të përgjithshëm të nënprojektit.**

**7.5 Përfituesi i nëngrantit është i obliguar të raportoj në MAPL çdo ankesë të pranuar në lidhje me nënprojektin, përfshirë edhe ankesat nga komuniteti dhe përfituesit e të rinjve të nënprojektit.**

#### **Neni 8 - Forca madhore**

Asnjë palë nuk mban përgjegjësi për mospërmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje në rast të forcës madhore.

#### **Neni 9 – Ndërprerja dhe pezullimi**

**9.1 Nëse MAPL-ja përcakton se përfituesi i nëngrantit nuk po i përdor fondet e mbështetjes financiare siç duhet për ta zbatuar projektin sipas kushteve të kësaj kontrate dhe kushteve në DNG dhe DOP ose ka dështuar ta zbatojë projektin brenda periudhës së kontraktuar, nëse nuk i ka dorëzuar raportet e duhura me kohë ose nuk e ka lejuar MAPL-në ose palët tjera të interesuara të përfshira në zbatimin e projektit siç përcaktohet në Doracakun për Nëngrante dhe Doracakun e Operacionit të Projektit që ta mbikëqyrin shfrytëzimin e fondeve, do të pezullohen pagesat e mëtejshme dhe përfituesi është i detyruar t'i kthej mjetet të shpenzuara jo si duhet dhe ato të paspenzuara brenda 30 ditësh nga marrja e njofimit me shkrim për rimbursim nga MAPL-ja.**

**9.2 Nëse MAPL-ja përcakton se marrësi nuk i ka përm bushur obligimet e veta kontraktuese, atij i mohonet e drejta për të marrë mbështetje financiare për dy vitet e ardhshme.**

### Neni 10 – Zgjidhja e konfliktit

Në rast të mosmarrëveshjeve gjatë zbatimit të kësaj kontrate ndërmjet palëve nënshkruese, të cilat nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim dhe diskutim të ndërsjellë, organi përgjegjës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë gjykata kompetente.

### Neni 11 – Nënshkrimi i marrëveshjes

Kjo Marrëveshje do të ekzekutohet në gjuhën shqipe në tre (3) kopje origjinale. Secila palë do ta mbaj nga një (1) kopje origjinale, ku secila do të ketë fuqinë e njëjtë juridike.

<p><b>Jeton QELA</b> <b>UD. Sekretarit të Përgjithshëm</b> - MAPL</p> <p> Nënshkrimi</p> <p>Data: <u>07.12.2023</u></p>	<p><b>Mehmet BALLAZHI</b> <b>KOMUNA E HANI I ELEZIT</b></p> <p> Nënshkrimi</p> <p>Data: <u>07.12.2023</u></p>	<p><b>Sumea ASALLARI</b> <b>Klubi i mundjes "Sharri"</b></p> <p>Nënshkrimi</p> <p>Data: </p>
--	--	---